



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ Prot

Datë 18.01.2024

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për Vitin 2024

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Bukë 15811100-7; Sheqer 15831000-2; Oriz 03211300-6; Miell gruri 15612100-2; Kripë 15872400-5; Vezë 03142500-3; Mish viçi 15111200-1; Djath i freskët 15542000-9; Kos 15551300-8; Qumësht 15511000-3; Gjizë 15542100-0; Gjalpë 15530000-2; Tërshërë 03211600-9; Fasule 03221210-1; Vaj gatimi 15411200-4; Vaj Ulliri 15411110-6; Reçelëra 15332290-3; Bizele 03221220-4; Thjerrza 03212211-2; Perime 03221000-6; Banane 03222111-4; Mollë 03222321-9; Portokalle 03222220-1; Pjeshkë 03222332-9; Mandarina 03222240-7; Miell misri 15612210-6; Patate 03212100-1;

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 3 908 283 (tre milion e nëntëqind e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Përmet** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Sipas Shtojcës 7, pika 1 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit"

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit që prokurohet.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 40 pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më

të madhe se 20% të vlerës së fondit të limit që prokurohet që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë apo mundësinë e OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe se nuk sjell kufizim të konkurrencës. Kjo vlerë është brenda limiteve të përcaktuara në LPP, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë çertifikata cilësie në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Certifikata e kërkuar është si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente.

- ISO 22000:2018 (Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore) ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në piken 1, të nenit 44, të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Kjo kërkesë dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë, sigurisë ushqimore.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës nëse është në një distancë më të madhe se 5 km nga institucionet që do të furnizohen, duhet të ketë në pronësi (ose me qera), një automjet të përshtatshëm ATV(frigofer) për të bërë transportimin e mallrave të vërtetuar me dokumentacion si (leje qarkullimi, siguracionin e mjetit, çertifikatën e kontrollit teknik, çertifikatë pronësie të mjetit dhe leje për transport mallrash të vlefshme, leja higjieno-sanitare e mjetit).

Shënim: Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu edhe bazuar në piken 6 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky vetëdeklarim kërkohet për të vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të produkteve objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qera ose në përdorim sipas kontratës noteriale, Magazinë ushqimore në rrethin e Përmetit për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës: Ambjentet duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

-Akt – Miratimi higjieno-sanitar,

-Deklaratë nga Operatori Ekonomik që ambjenti i plotëson kriteret e kërkuara.

Shënim: Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriterëve është bere ne përputhje dhe me Rekomandimin Nr. 10181 Prot, date 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore”, te Agjencise se Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit, publikuar ne adresen www.app.gov.al .

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara gjykojmë se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë Liçencë, kategoria II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Ky kriter është vendosur bazuar në pikën III të Rekomandimit nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

2.3.6 Operatori duhet te paraqese vetedeklarim, ku te deklaroje se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore. Operatori ekonomik i shpallur fitues perpara lidhjes se kontrates ka detyrimin te paraqese dokumentacionin provues, ku te provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Paraqitja e këtij vetedeklarimi është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet te rregullt në përputhje me legjislationin në fuqi për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit. Ky kriter është vendosur me qellim që ti shërbeje AK për te siguruar cilësinë e ushqimeve, qe do të prokurohen.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë vendosur në bazë të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, si dhe në perputhje nën 36, të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nën 40 , pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 29.01.2024, ora 12:00.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për Vitin 2024”.

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.
Bashkëlidhur këtij procesverbal:
Dokumentat e tenderit.
Specifikimet teknike

NJËSIA E PROKURIMIT

MIRATOI
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Alma HOXHA